

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, **nr. 115**, prill – qershor 2025
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter **Hysaj**
Ky numër u sponsortizua nga:
Bako Xhaferaj



KONTRIBUTI I KALLARATASVE NË LUFTËN KUNDËR PUSHTIMIT ITALIAN MË 7 PRILL 1939

Ahmet Zogu, kur erdhi në fuqi, e lidhi Shqipërinë me Jugosllavinë dhe me Italinë. Që nga viti 1925 e deri në fund të mbretërimit të tij Zogu nënshkroi me Italinë një varg marrëveshesh skllavëruese, duke ia shitur Shqipërinë Italisë dhe duke e vënë shtetin shqiptar nën varësinë e plotë të Italisë fashiste të Musolinit. Të gjitha këto shpunë në ditën e zezë të 7 prillit 1939. Dita e së premtes së zezë të 7 prill 1939 për Shqipërinë ishte përgatitur qysh më 20 dhjetor 1924, ditën kur Zogu përmbysi qeverinë e Fan Nolit. Për të përmbushur interesat e veta dhe...

Faqe 2



KALLARATIN NUK E DUAN VETËM KALLARATASIT



Faqe 9

5 MAJ 2025

NË KALLARAT PËRKUJTOHEN DHE NDEROHEN DËSHMORËT



Faqe 3

“NË GJURMËT E SË KALUARËS, LULËZON E ARDHMJA”



Më 18 maj 2025, “Fshati i Djegur” në Kallarat, i gjendur në një cep të lashtë të Labërisë, ku historia nuk është vetëm e shkruar, por edhe e gdhendur në gurë, u mbush me jetë, zëra, ngjyra dhe muzikë. Në këtë vend që mban në gjoks plagët e së kaluarës, por edhe krenarinë e qëndresës, u zhvillua edicioni i dytë i Piknikut Pranveror, një organizim i Shoqatës Kulturore dhe Atdhetare “Kallarati”, që me çdo aktivitet të tillë mbjell dashuri për...

Faqe 14

11 MAJ 2025, 180 ÇIKLISTËT MË TË MIRË TË BOTËS, NË ETAPËN E TRETË GARUAN PËRGJATË RRUGËS AUTOMOBILISTIKE TË LUMIT TË VLORËS, DUKE PËRSHKRUAR PËR DISA MINUTA EDHE KALLARATIN

Faqe 17



KONTRIBUTI I KALLARATASVE NË LUFTËN KUNDËR PUSHTIMIT ITALIAN MË 7 PRILL 1939

MARRË NGA LIBRI "HISTORIKU I KALLARATIT", SHKRUAR NGA ENVER STRATI (ndarë nga jeta)

Ahmet Zogu, kur erdhi në fuqi, e lidhi Shqipërinë me Jugosllavinë dhe me Italinë. Që nga viti 1925 e deri në fund të mbretërimit të tij Zogu nënshkroi me Italinë një varg marrëveshesh skllavëruese, duke ia shitur Shqipërinë Italisë dhe duke e vënë shtetin shqiptar nën varësinë e plotë të Italisë fashiste të Musolinit. Të gjitha këto shpunë në ditën e zezë të 7 prillit 1939.

Dita e së premtes së zezë të 7 prill 1939 për Shqipërinë ishte përgatitur qysh më 20 dhjetor 1924, ditën kur Zogu përmbysi qeverinë e Fan Nolit. Për të përmbushur interesat e veta dhe çifligarëve që qëndronin pas tij, atij nuk i mjaftoi hapja e portave kanatë kapitalit italianë, duke ia shitur Shqipërinë Duçes në këmbim të ndihmës që i dha për vetëshpalljen më 1 shtator 1928 mbret i Shqiptarëve. Sipas një shkrimi të datës 17 prill 1939 të gazetës angleze "Times Magazine", "koha e pushtimit të Shqipërisë fillon që nga traktati i Tiranës i nënshkruar midis Duçes dhe Zogut më 27 nëntor 1926 në Livorno, i cili e bënte Shqipërinë vasale të fqinjit më të fortë (Italisë), që ajo e shkeli me 7 prill 1939".

Për këtë flasin dokumentet arkivore dhe dëshmi të njerëzve mirinformuar të asaj kohe. Që nga viti 1925 e deri më 1939 Italia fashiste kishte dhënë Zogut një miliard e 837 milionë lireta vetëm për të mbajtur një ushtri prej 675 oficerë dhe 6000 nënoficerë, gardistë dhe ushtarë aktive. Nga 1936 deri më 1939, Zogu kishte marrë nga Italia afro 3 milionë e 500 mijë franga ari në vite. Me nënshkrimin e marrëveshjes së vitit 1936, mijëra këshilltarë dhe specialistë fashistë zunë pozitat kyçe në ushtri, xhandarmëri, ekonomi, arsim, kulturë etj; vetëm në ushtri në postet më të larta ishin caktuar 280 oficerë fashistë. Ishin këta që sabotuan mbrojtjen e shqiptarëve duke hequr gjilpërat e armëve.

Zogu, në vend që të mbathte opingat dhe të dilte në mal, sikundër trumbetonin ministrat e tij, ia mbathi vetë, duke grabitur edhe arin e Bankës së Shqipërisë dhe duke e lënë Shqipërinë të çarmatosur dhe të turpëruar para botës për herë të parë në historinë e saj.

Disa pseudohistorianë dhe pinjollë të Zogut shkruajnë se "Zogu nuk e kishte miratuar pushtimin e Shqipërisë dhe nuk e kishte abdikuar fronin" dhe se "ai qëndroi në Angli si njeri i thjeshtë". Po faktet dëshmojnë të kundërtën. Gazeta "Liktori" e 29 korrikut 1939 përshkruan me hollësi arratisjen e Zogut, grabitjen e thesarit të shtetit, mbërritjen në Varshavë me 68 valixhe, zënien e 25 dhomave në hotelin më të mirë, ku paguante 15.000 korona në natë. Njëra nga dhomat ku kishte thesarin e tij, ruhej me roje të përforcuara. Ndërsa një gazetë



tjetër shkruante se kur mbërriti në Stokholm kishte 111 valixhe dhe se u prit me padurim nga tregtarët e sendeve me vlerë. Për sa i përket pohimit të këtyre "historianëve" se Zogu nuk e abdikoi fronin, le t'i referohemi nenit 65 të Statutit të Mbretërisë të vitit 1928, ku thuhet: "Mbreti, po u largua me tepër se tre muaj nga vendi, humbet të drejtën e fronit."

Se cili ishte Ahmet Zogu, të cilit sot disa njerëz i thurin himne, mjafton të sjellim vlerësimin e Faik Konicës, ambasador i Shqipërisë në SHBA, dhënë më 1938 njërit prej njerëzve më të afërt të Zogut: "E përbuz mbretin për këto arsye: E kam vëzhguar që kur ishte 18 vjeç dhe asnjëherë nuk e kam dëgjuar të thotë një të vërtetë. Kurrë nuk e ka mbajtur fjalën dhe besën. Nuk ka asnjë ndjenjë përgjegjësie. Është i pandershëm, i pashpirt, egoist, i pangopur. Ai urren të gjithë ata që kanë diçka, qoftë kulturë, prejardhje, pasuri, çfarëdo aftësie në ndonjë fushë ose qoftë dhe patriotizëm, të pagdhendur, por të ndershëm. Ai i injoron gjërat themelore dhe u jep rëndësi groteske çikërrimave. Shqipëria kurdoherë ka qenë njohur si komb me njëfarë dinjiteti tragjik, ai e ka ulur Shqipërinë në nivelin e një farse muzikore pa vlerë."

Më 7 prill, në mëngjes, nga prapa Bogonicës e Çikës u shfaqën në qiell aeroplanë që morën në drejtim të Vlorës. Nga organet e pushtetit vendor nuk ishte dhënë asnjë njoftim a udhëzim për popullatën, po fshatarët e kuptuan se Shqipëria po robërohej përsëri. Me nismën e disa pjesëmar-

rësve të luftës së Vlorës, si Veip Balili, Xhemil Xhelo, Maze Jonuzi, Shaqo Nuro, Adil Petani etj, në Qafën e Ubavit u mbledhën mbi 40 burra dhe u nisën për në qendrën e komunës në Kuç për të kërkuar armë. Po autoritetet e komunës u thanë të shpërndaheshin dhe të shkonin nëpër shtëpitë e tyre, mbasi nuk kishte ngjarë ndonjë gjë me rëndësi. Po të ishte nevoja të luftohej, do të lajmëroheshin. Burrat u kthyen në fshat të pikëlluar dhe të revoltuar në kulm me mbretin, që e dorëzoi vendin pa luftë. Lajmi i pushtimit fashist, që nuk vonoi të vinte, tronditi të madh e të vogël në Kallarat.

Në qytete, protestat dhe manifestimet antifashiste kishin nisur që në ditën e para të prillit. Në këto demonstrata morën pjesë edhe bijtë e Kallaratit Mumin Selami, Sinan Petani, Xhemal Gjoni, Sinan Petani, Nuredin Breshani e Abdurrahman Zhibi. Në manifestimin e datës 5 prill Mumini shkëputet nga turma dhe ngre flamurin kombëtar në kullën e sahatit. Më 7 prill, Mumini, Sinan Petanini e të rinj të tjerë shkuan në kazemat Ali Rizait, hapën magazinat e xhenios, marrin armët e ushtrisë së falimentuar dhe nisen për të luftuar në Durrës, por informohen se ishte pushtuar. Edhe punëtorët kallaratas që punonin në Kuçovë, Feti Tozaj, Hariz Gozhi, Xhafer Xhaferi, Kasëm Demiri, Dalan Abazi dhe Azbi Breshani, me 6 prill 1939, me një grup demonstruesish shkojnë në Berat, shpërthejnë burgun dhe me bashkë me të burgosurit paraqiten

në organet qeveritare për t'i pajisur me armë, por s'ua vuri veshin njeri.

Mes atyre qindra oficerëve e nënoficerëve të ushtrisë mbretërore pati edhe patriotë që iu përmbytën betimit ushtarak. Ashtu si në Durrës Mujo Ulqinaku me shokë i priti me zjarr pushtuesit që zbarkonin nga anijet, edhe Skelë të Vlorës trupat fashiste hasën në qëndresë të fortë. Aty një grup burrash, ndër të cilët ndodhej edhe nënoficeri i xhandarmërisë Abaz Shakaj, i gozhduan për disa orë, duke u shkaktuar humbje të konsiderueshme në njerëz.

Pasi zunë Vlorën, fashistët shpejtuan të push-tonin Fierin, Kuçovën dhe Beratin. Në orën 13-14 të 7 prillit, një batalion bersalierësh, të hipur në biçikleta, nisën drejt Fierit. Por në Bestrovë të Vlorës u pritën nga zjarri i forcave ushtarake shqiptare. Pjesë e këtyre forcave ishte dhe bateria kundërajrore që komandohej nga bashkëfshatari ynë Shahin Osmën Jonuzaj, e cila ishte nisur për të luftuar në mbrojtje të Vlorës. Luftimet e zhvilluara tek Çezma e Bestrovës ishin të rrepta; megjithëse të mbështetur nga aviacioni, bersalierët u bllokuan në vend dhe vetëm më 8 prill, kur erdhën forca të tjera në ndihmë, forcat fashiste mund të kalonin. Për luftën e zhvilluar në Skelë (Vlorë) dhe në Bestrovë, gjeneral Guxoni, në fjalimin e mbajtur në stadiumin e Tiranës, tha: "Dëmet me të mëdha e të konsiderueshme i kemi pasur në Vlorë".

Shahini, në shënimet e tij për këtë luftë, thotë:



“Ishim në Elbasan, morëm urdhër që bateria ku unë isha komandant, të shkonte për të mbrojtur portin e Semanit. Prej këtej u urdhëruam që me shpejtësi të niseshim për mbrojtjen e portit të Vlorës. Në orën 12 të datës 7 prill 1939 arritëm në fshatin Pestrovë, jo shumë larg Vlorës. Në kohë mbërriti batalioni i bersalierëve të hipur në biçikleta që shkonin për të pushtuar Fierin. U detyruam t’i prisnim me luftë.”

Në ato ditë prilli 1939, vëllai i madh i Mumin, Hasani, student në Egjipt, pikëllohet për pushtimin e vendit të tij. Së bashku me një grup patriotësh shqiptarë, të emigruar në Egjipt, Hasani shkon si përkthyes për të protestuar pranë ambasadës amerikane dhe angleze në Kajro kundër agresionit fashist në Shqipëri. Ai grumbulloi rreth vetes studentë të huaj dhe shqiptarë dhe shkoi për të protestuar përpara përfaqësive diplomatike të huaja në Kajro, duke deklaruar: “Ç’kërkon fashizmi italian në Shqipëri, ajo nuk i ka borxhe askujt, prandaj ata duhet të kthehen nga kanë ardhur.”

Menjëherë pas pushtimit të vendit, autoritetet fashiste nisën burgosjet dhe internimet e patriotëve. Kështu, Mumin Selami, Sinan Petani dhe Nuredin Breshani përjashtohen nga shkolla si të padëshirueshëm dhe më vonë burgosen si pjesëmarrës në demonstrata. Mumini, për arsye se në demonstratën e zhvilluar më 28 nëntor 1939 në Tiranë nuk lejoi që flamurit shqiptar t’i viheshin sëpatat e Liktorit, internohet në Kallarat, nën survejimin e organeve sekrete të “Simit”

Sjelljet e tyre prej pushtuesi treguan se Italia fashiste nuk kishte ardhur për ta zhvilluar Shqipërinë, po për të grabitur pasuritë e saj dhe për të shfrytëzuar krahun e lirë të punës. Shumë bashkëfshatarë që punonin në shoqëritë italiane “Çelpa”, në minierën e Selenicës, në AIPA në Kuçovë, në Policel (botore) e gjetkë, si Hariz Goxhi, Veip Memushi, Muço Gjombati, Çune Qejvani, Feti, Ferik, Sinan e Sihat Tozaj, Dalan Abazi, Ferik Golloshi, Sefer Malo, Besim dhe Thanas Shahaj, Filo Breshani, Azbi Breshani, Kapo Habili, Hasan Qejvani etj. për 14–16 orë në ditë merrnin 8 lekë, një bukë dhe disa kokrra aspirina për të luftuar malarien dhe flinin në garazhe ose kasolle. Punonin në kushte tepër të rënda dhe trajtoheshin keq nga punëdhënësit dhe brigadierët italianë. Duke punuar pa masa sigurie, Muço Gjombati u aksidentua në punë dhe ngeli invalid nga këmba, pa fituar dëmshpërblim.

Shumë nga këta kishin luftuar kundër italianëve më 1920–ën, prandaj, megjithëse nevojtarë, prisnin rastin të shpërthenin. Ata nuk zbatonin urdhrat e italianëve për të nderuar flamurin italian, si dhe urdhra të tjerë të ngjashëm që shkelnin dinjitetin e tyre kombëtar. Kurse ditën e Flamurit, më 28 Nëntori 1939, ata nuk vajtën në punë, por hynë të gjithë në grevë, duke kënduar këngë labe, këngë kombëtare dhe këngë kundër italianëve. Drejtuesit e AIPA-s, të shqetësuar nga veprimet e tyre, u hakmorën duke pushuar mjaft punëtorë nga puna, ndër ta edhe sindikalistët e vjetër Feti

Më 7 prill, në mëngjes, nga prapa Bogonicës e Çikës u shfaqën në qiell aeroplanë që morën në drejtim të Vlorës. Nga organet e pushtetit vendor nuk ishte dhënë asnjë njoftim a udhëzim për popullatën, po fshatarët e kuptuan se Shqipëria po robërohej përsëri. Me nismën e disa pjesëmarrësve të luftës së Vlorës, si Veip Balili, Xhemil Xhelo, Maze Jonuzi, Shaqo Nuro, Adil Petani etj, në Qafën e Ubavit u mblodhën mbi 40 burra dhe u nisën për në qendrën e komunës në Kuç për të kërkuar armë. Po autoritetet e komunës u thanë të shpërndaheshin dhe të shkonin nëpër shtëpitë e tyre, mbasi nuk kishte ngjarë ndonjë gjë me rëndësi. Po të ishte nevoja të luftohej, do të lajmëroheshin. Burrat u kthyen në fshat të pikëlluar dhe të revoltuar në kulm me mbretin, që e dorëzoi vendin pa luftë. Lajmi i pushtimit fashist, që nuk vonoi të vinte, tronditi të madh e të vogël në Kallarat.

Tozaj e Hariz Goxhaj.

Kundërshtime ndaj pushtuesit fashist pati edhe në radhët e ushtarakëve. Në vjeshtën e 1940–ës, Italia fashiste sulmoi Greqinë, duke hedhur në luftë edhe batalione shqiptare. Por ushtarët shqiptarë, të çuar me forcë në frontin grek, braktisën frontin. Me gjithë propagandën profashiste të njerëzve që ishin vënë në shërbim të fashizmit se Italia do të bënte Shqipërinë e madhe, si Xhemil Meçua, Hysni Lepenica etj, 9 kallaratas braktisën frontin dhe shumë nga të rinjtë që kishin radhën për të kryer shërbimin ushtarak, nuk shkuan në ushtri, po u fshehën pyjeve.

Fatkeqësitë më të mëdha për popullin e Kallaratit erdhën kur grekët e vunë përpara ushtrinë italiane dhe hynë në tokën shqiptare. Trupat greke u vendosën në vijën që ata e konsideronin Vorio Epir: Qafa e Gurrës–Përroi i Thatë i Vranishtit–Lumi i Smokthinës–Vërmik–Tepelenë etj. Kështu që Kallaratit mbeti në zonën e pushtimit grek, pranë vijës së luftimit. Fshati u kthye në një arenë lufte midis italianëve dhe grekëve. Çdo ditë italianët hidhnin qindra predha artilerie dhe bomba aviacioni, që shkatërronin shtëpitë dhe e mbushën vendin me gropa që dukeshin edhe pas 30 vjetësh. Vendi u mbush me gropa bombash. Për t’u shpëtuar bombardimeve, njerëzit morën malet dhe grykat e përrnjve.

Një ditë në mbrëmje, banorët e zonës Ndrekshti, Përroi i Gjormë e Armixore u njoftuan

nga grekët që të nesërmen që në mëngjes herët të largoheshin, se italianet do të bënin bombardime me artileri dhe aviacion në këtë zonë. Familjet e Teslim e Dule Stratit ikën dhe u fshehën në Përroin e Skordhollit, duke u futur poshtë shkëmbinjeve. Plackat i lanë në vend, do të ktheheshin, pas pushimit të bombardimeve. Italianët nga Ramica dhe Brati qëllonin me top (xhebel i thoshin), nga lart binin bombat e aviacionit, Vendi dridhej nga shpërthimet, që dëgjoheshin gjithandej. Kur u kthyem në mbrëmje, ishte të vije duart në kokë. Një gjyle kishte goditur ballin e shtëpisë (haurit). Veç plaçkave, që ishin djegur, hambari me 2 kv misër kishte fluturuar në ajër, 300 m larg. Gjysma e misrit ishte djegur dhe i përhapur në tokë. Ishte dëmtuar buka me të cilën do kalonin dimrin. E mblodhën si pulat kokërr më kokërr, të djegurin më vete, që e përdorën si kokoshka.

Në palcën e dimrit, grekët e urdhëruan popullsinë të zhvendosej në drejtim të Kuçit. Njerëzit u strehuan pyjeve të Kuçit, duke ndarë një kasolle dy-tri familje bashkë, dhe u kthyen prej andej në prill 1941 kur ushtria greke u largua. Populli vëlla dhe bujar i Kuçit, megjithëse dhe ai në gjendje të vështirë, na priti me dashuri vëllazërore. Të gjithë pa përjashtim na vunë në dispozicion, sipas mundësive, shtëpi, kasolle, disa shtresa e mbulesa.

Qe fat që më 19 prill 1941 ushtria greke u largua me shpejtësi, për shkak se Greqia u pushtua nga gjermanet. Kur njerëzit u kthyen në shtëpitë,

i gjetën ato të shkatërruara krejt, pa dyer e pa dritare, me orendi dhe shtresat e mbulesat të djegura, si dhe drurët frutorë të prerë. Që atëherë në Kallarat, për një dëm të madhe e shkatërrim të diçkaje thonë: “Sikur ka rënë greku”. Njerëzit nuk kishin asgjë për të ngrënë. Me shkrirjen e borës, ushtrisë greke, që dimrin e kishte kaluar duke lypur dhe duke u vjedhur bagëtinë fshatarëve, i erdhën furnizime të mëdha me ushqime. Po gjatë tërheqjes grekët kishin bërë nevojën mbi pirgjet e galetave, kështu që nuk mund të përdoreshin.

Nga mungesa e ushqimit, e strehimit, e veshmbathjeve, shtresave e mbulesave dhe ashpërsia e dimrit shumë fshatarë u sëmurën rëndë. Brenda tre muajsh vdiqën 9 vetë: Ferat Halo Llani me djalin e tij Gaço Llani, që la 5 fëmijë të vegjël jetimë, Nure Balil Golloshi me dy fëmijë të vegjël, Ali Thanas Qesëraj, Alush Jonuzi, Zenepë Toçi, Myrto Zani, Hamit Leven Ribi (djale i vetëm 17-vjecar), Shako Veip Xhaferi. Këto vuajtje Mumin Selami i ka pasqyruar në Ditarin e tij, në shkrimin “Nuk di në është paqe apo jo?”.

Fatkeqësitë nuk mbaruan me kaq. Nga armatimet dhe municionet luftarake që ushtria greke kishte lënë gjithandej, sidomos nga bombat u vranë 3 djem nga 12–14 vjeç: Hamit Halil Abazi, Vehbi Zano Zhibi e Beqir Selfo Golloshi; kurse Dasho Memush Memushaj preu të dy duart duke mbetur invalid. Më vonë, nga bombat e mbetura të fashizmit plagoset edhe Haxhi Birbil Karabolli.

Gjatë periudhës 4- mujore që greku qëndroi në fshat i shkaktoi ekonomisë së fshatit dëme ekonomike të pallogaritshme. Theri mbi 3000 kokë bagëti të imta e 40 gjedhë; humbën edhe mbi 50 kafshë ngarkese. U grabit e u shkatërrua e gjithë baza ushqimore për njerëz dhe bagëti. Për shembull, Teslim Strati, kur erdhën grekët, kishte mbi 200 dhi, ndërsa kur iku ushtria greke i kishin mbetur 14 kokë. Dëme të mëdha u bënë si nga gjylet dhe nga bombat në kafshët dhe në të mbjellat e vjeshtës. Atë pranverë të 1941-së, megjithëse në fund të prillit, për mungesë fare dhe të pendëve të qeve tokat nuk u mbollën.

Pushtuesi italian, që qe shaktari i gjithë kësaj tragjedie, nuk i dha popullit asnjë ndihmë. Madje, në tetor 1941, SIM-i (policia e fshehtë fashiste), i informuar nga agentët të tij, kapi dhe rrahu rëndë në Vlorë Telo Duro Zhibin për ta detyruar të tregonte floririn e marrë nga avioni jugosllav që u përplas në pyllin e Ramanait, kufi me Kuçin, në të cilin ishin ministrat jugosllavë që po shkonin për strehim në Greqi pas pushtimit të Jugosllavisë. Fashistët dërguan karabinierë në Kallarat për të marrë floririn e fshehur në dyqan nga Telua dhe arrestuan Veip Balil Memushin, të cilin e burgosën në Vlorë dhe më pas e dërguan në burgun e Tiranës, ku e mbajtën 6 muaj pa vendim gjykate.

Këto fatkeqësi që i shaktuan vendit dhe sjelljet e tyre prej pushtuesi e shtuan urrejtjen e popullit për fashistët. Kundërshtimi i tij shfaqej në forma nga më të ndryshmet. Dalan Memushaj në librin e tij “Ditët kur luftova” tregon se si Adil Petani, Ormën Ribit dhe ai shpërfillën rregullat që qytetarët shqiptarë duhet të respektonin gjatë ceremonisë së uljes së flamurit italian në Skelë të Vlorës: “Adili na tha mua e Ormënit që të mos ndalonim për respektimin e rregullave për uljen e flamurit dhe, në qoftë se do të merrnin masa, do t’u thonim se ishin fshatarë që nuk dinim italisht, nuk merrnim vesh nga këto rregulla, sepse kishim zbritur nga fshati... Ndërkohë që marinarët italianë ndërmorën veprimet për uljen e flamurit, ne, si kalimtarë dhe si njerëz që gjoja nuk merrnim vesh, vazhduam rrugën për në Vlorë. U futëm brenda periferisë, ku ushtarët dhe disa kalimtarë të tjerë kishin ndaluar në qëndrimin “gatitu”. Veprimi ynë mospërfillës ra në sy për keq. Me t’u dhënë sinjali i bories “qetësohu”, marinarët italianë, të revoltuar, duke sharë u lëshuan drejt nesh dhe na ndaluan. Në çast, na hodhën hekurat dhe na çuan në komandën e marinës. Aty na hipën në një makinë dhe na shpunë në kuesturë. Sapo na futën brenda, filluan të na pyesnin me hollësi se nga ishim dhe si quheshim, na kërkuan llogari se përse nuk ndalua kur boria dha sinjalin për uljen e flamurit etj... Në burg na mbajtën deri nga mesi i natës, pastaj na lanë të lirë, duke na porositur që të ishim të vëmendshëm dhe të mos thyenim rregullat e italianëve, se, ndryshe, herë tjetër, në qoftë se do të bënim ndonjë veprim të tillë, do të na dënonin rëndë.”

Marrë nga Libri “Historiku i Kallaratit”, shkruar nga Enver Strati

— 5 MAJ 2025 —

NË KALLARAT PËRKUJTOHEN DHE NDEROHEN DËSHMORËT

Siç na njofton korrespondentja e shoqatës, Elena Memushaj, edhe banorët e Kallaratit, kujtuan sot dëshmorët e fshatit që dhanë jetën për çlirimin e vendit. Me këtë rast pranë lapidarit në emër të Kryesisë së Këshillit të Fshatit, të Organizatës së Dëshmorëve dhe Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, familjeve të dëshmorëve dhe banorëve të fshatit, u vendosën kurora e buqeta me lule. Vlerësim e Mirënjohje gjithë atyre që dhanë jetën dhe kontributin për lirinë e atdheut!

Mirënjohje kryesisë fshatit, organizatave të dëshmorëve dhe të veteranëve të LANÇ-it dhe gjithë bashkëfshatarëve në Kallarat që sot morën pjesë në këtë përkujtim.

Lavdi për jetë dëshmorëve të Kallaratit dhe të Shqipërisë!

Më vonë ceremonia përkujtimore e , "Ditës së Dëshmorëve" vijoi në një drekë të përbashkët pa dallim, të banorëve të fshatit në restorantin e Zeqo Hoxhaj.



5 MAJ, “DITA E DËSHMORËVE

LAVDI DËSHMORËVE TË ATDHEUT!
LAVDI DËSHMORËVE TË KALLARATIT!

Në këtë ditë të shënuar kujtojmë me respekt e me mirënjohje të thellë jetën dhe veprën e dëshmorëve të Kallararit, që dhanë jetën për lirinë e Atdheut.

RËNË NË LUFTË NDAJ ANDARTËVE
GREKË MË 1914.

- 1. Murat Avdul Demiraj
- 2. Dervish Sali Maçaj
- 3. Ramadan Muhamet Hoxhaj
- 4. Çelo Mustafa Boshaj
- 5. Hyso Balil Xhaferaj

RËNË NË LUFTË KUNDËR FASHISTËVE
ITALIANË MË 1920.

- 1. Xhevair Musa Golloshaj

RËNË NË LUFTËN NACIONALÇLIRIM-
TARE KUNDËR NAZIFASHISTËVE.

- 1. Mumin Selam Bajramaj
- 2. Adil Lame Petanaj
- 3. Ali Birçe Ribaj
- 4. Ali Sulo Memushaj
- 5. Avdul Demir Demiraj
- 6. Ferik Miftar Golloshaj
- 7. Ferik Teslim Strataj

- 8. Filo Faslli Breshanaj
- 9. Hamdi Shuaip Sheraj
- 10. Hamza Malo Qejvanaj
- 11. Hasan Laze Qejvanaj
- 12. Islam Tasim Janaj
- 13. Lilo Dine Habilaj
- 14. Nelo Nazer Hysaj
- 15. Nexhip Shuaip Sheraj
- 16. Nuredin Selam Breshanaj
- 17. Ormen Boro Ribaj
- 18. Shuko Ramo Karabollaj
- 19. Tare Çelo Gjonaj
- 20. Zyber Shuaip Sheraj

RËNË PËR MBROJTJEN E
DEMOKRACISË

- 1. Elham Sulejman Sheraj (Elezi)

QOFTË I PAHARRUAR
KUJTIMI I TYRE!

24 Maj 1944 - 24 Maj 2025

81 Vjetori i Kongresit të Përmetit

Në këtë kongres mori pjesë edhe biri i Kallararit, Xhafer Hyso Xhaferaj, ish partizan i Brigadës së 8 - të Sulmuese. Vlerësim e mirënjohje për kontributin e tij, dhënë krahas shumë bashkëfshatarëve kallاراتas, për çlirimin e atdheut dhe më pas për ndërtimin dhe mbrojtjen e vendit



GËZUAR 1 QERSHORIN,
FESTËN E FËMIJËVE!

*Të dashur fëmijë të
Kallararit dhe mbarë
Shqipërisë!*

*Qoftë kjo ditë
e mbushur me
buzëqeshje, lojëra dhe
dashuri!*

*Ju jeni drita e së
ardhmes, gëzimi i
prindërve dhe shpresa
e vendit.*

*U rritshi të lumtur, të
mbrojtur e me ëndrra
të mëdha!*





PETER M. TASE

Peter M. Tase: Koncepti i Kallararit të Djegur nga Greqia më 1914 meriton vëmendje nga Tirana

Ndërsa Shërbimi Sekret Grek vazhdon të investojë me miliona euro pa fund kundrejt destabilizimit politik-social të Shtetit Shqiptar, në këtë periudhë zgjedhjesh të përgjithshme parlamentare; vlen të sjellim në vëmendje masakrat e tmerrshme të ANDARTËVE GREKË kundër popullit Shqiptar në fshatin Kallarat, ku mbi 130 shtëpi u dogjën bashkë me qindra gra e fëmijë. Jehona e qëndresës së armatosur të Kallararit kundër barbarëve GREKË, është përcjellë nga brezi në brez nëpërmjet rrëfimeve të të parëve dhe këngëve popullore. Nëpërmjet këtyre vargjeve reflektohet heroizmi i luftëtarëve shqiptar të kësaj treve me gjurmë të thella atdhedashurie;

në Strakëna. Pjesa më e madhe e tyre u vendosën pikërisht këtu në këtë pllajë rrrëzë Bogonicës, të quajtur Pelingri, duke ndërtuar një fshat me një planimetri për t'u marrë shembull edhe sot.

Në 111 vjetorin e masakrave kundër popullit shqiptar, drejtuar nga ANDARTËT GREKË; në vitet 1912 – 1914, dashuria kombëtare duhet lartësuar dhe historia e Shqipërisë në Shek. XX është vendimtare dhe na mëson shovinizmin Grek dhe genocidin Grek kundër popullit Shqiptar dhe arbëror. Banorët e Kallararit, pas qëndresës së fortë kundër barbarëve andartë GREK, u detyruan ta braktisnin fshatin dhe të strehoheshin në Vranisht e Mesaplik. Më 1914, Andartët dogjën e bënë shkrumb e hi me gjithë ç'kishin brenda të gjitha

shtëpitë dhe xhaminë: rreth 130 shtëpi u dogjën. U grabitën afro 1500 kokë bagëti të imta, mjaft qe, lopë e kuaj. Në këtë luftë të përgjithshme për mbrojtjen e trojeve u vranë shumë nga andartët grekë, midis tyre edhe luftëtarët: Murat Avdul Demiraj; Dervish Sali Maçaj; Ramadan Muhamet Hoxhaj; Çelo Mustafa Boshaj; Hyso Balil Xhaferaj. Ndërsa të tjerë kallaratas si Muço Barjam Karabollaj, Yzeir Medin Ribaj e Sali Maçaj, u kapën nga andartët dhe u burgosën në ishullin grek të Korfuzit, ku u torturuan deri në vdekje. Mjaft të tjerë si Cane Demiri, i cili vdiq nga plagët, Rexhep Bego, Lulo Gjoni, Nebo Qejvani, Isa Petani, Feim Strati, Demir Demiri, Xhebro Boçaj e Hito Boçaj u plagosën. Pasi ushtria pushtuese italiane përzuri grekët më 1916, banorët u kthyen në fshat, që ishte bërë i pabanueshëm dhe u vendosën pranë arave, në të dy krahët e lumit Shushica. Nga ai fshat i bukur, më i bukur i luginës së Shushicës, sot kanë mbetur vetëm rrënojat e shtëpive dhe

toponimi “Fshati i Djegur”. Është detyrë e Presidentit Bajram BEGAJ, dhe Tiranës zyrtare të vendos në lëvizje ato pak instrumenta shtetëror për të neutralizuar shovinistët modern Grekë që gjithmonë e më shumë janë aktiv në destabilizimin e ekonomisë, përcytnimin e sovranitetit territorial, dhe përdhosjen e sigurisë kombëtare të Arbërisë tonë të bekuar.

Le të mos harrojmë kurrë masakrat si ajo e Kosinës në Përmet, Hormovës në Tepelenë, Panaritit në Korçë, Borshit në Sarandë, ku bandat shoviniste nga Greqia, bënë shumë masakra dhe reprezalje deri në zonën Skrapar- Berat. Ngjarjet e kobshme të 1914, përmes tregimeve të autorit Kosta Papa Tomorri, i cili i ka parë me sytë e tij disa nga masakrat e lartpërmendura; janë të tmerrshme dhe vigjilenca patriotike NUK duhet të flejë në këto momente destabiliteti gjeopolitik.

Marrë nga Gazeta Telegraf
- 23 Prill, 2025



“Ç’ka Harca e Madhe që qan?

Tymi si mjegull u ça!

U tund Bogonicë e s’ra!

Mavrova kundreq e pa

Kallarati u bë hata.

Bini o burra në ta,

se greku në qafe na ra.

Luftojnë burra e gra!”

Sipas shkrimtarit Lefter HYSAJ, Kallarati është një fshat i vjetër, i cili më parë ka qenë i vendosur rrëzë Kunjovës, midis Bolenës dhe Kuçit, një fshat i madh që siç thotë rapsodi popullor: “Kallarati për veri/ në Kunjovë për karshi,/ një mij’ e dyqind shtëpi,/ me dyqanë e magazi/, ra kolera e bë kërdi,/ në një ditë treqind e dy.”

Pra, sipas gojëdhënave dhe dokumenteve të asaj kohe, thuhet se, nga shkaku i sëmundjes së rëndë të kolerës, që ra rreth viteve 1660 – 1720, kallaratasit u shpërndanë në shumë fshatra fqinje, si: Pilur, Borsh, Piqerras, Sasaj, Lukovë, Shën-Vasil e gjetkë, madje edhe në ishujt e Greqisë, si

Në 111 vjetorin e masakrave kundër popullit shqiptar, drejtuar nga ANDARTËT GREKË; në vitet 1912 – 1914, dashuria kombëtare duhet lartësuar dhe historia e Shqipërisë në Shek. XX është vendimtare dhe na mëson shovinizmin Grek dhe genocidin Grek kundër popullit Shqiptar dhe arbëror. Banorët e Kallararit, pas qëndresës së fortë kundër barbarëve andartë GREK, u detyruan ta braktisnin fshatin dhe të strehoheshin në Vranisht e Mesaplik.



NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E EDICIONIT TË DYTË TË “PIKNIKUT PRANVEROR” KALLARATI JU MIRËPRET NË PIKNIKUN PRANVEROR NË “FSHATIN E DJEGUR” MË 18 MAJ 2025

Të dashur kallaratas, miq e dashamirë, më 18 maj 2025, ju ftojmë të bëheni pjesë e një ngjarjeje që ka lindur nga zemra dhe shpirti i vendlindjes – Pikniku Pranveror në Fshatin e Djegur, në Kallarat!

Ky është edicioni i dytë i një tradite që sapo ka filluar të marrë jetë, por që tashmë ka fituar zemrat tona. Le ta kthejmë këtë datë në një pikë takimi të përvitshme, në një festë të dashurisë për natyrën, për rrënjët tona, për kujtesën historike dhe për trashëgiminë kulturore që kemi detyrë ta ruajmë e ta përcjellim brez pas brezi.

Ejani! Mos e humbisni këtë ditë! Ejani me miqtë, familjen, fëmijët dhe dashurinë për vendlindjen në zemër. Fshati i Djegur do të mbushet me gjallëri, me zëra gëzimi, me këngë labe që çajnë malin dhe me valle që ndezin shpirtin.

Do të ndalemi pranë lapidarit të dëshmorëve të vitit 1914, për t'i nderuar siç e meritojnë ata që dhanë jetën për të mbrojtur trojet tona nga andartët grekë. Sepse një popull që respekton të shkuarën, ndërton me dinjitet të ardhmen.

Mos mungoni të vizitoni trojet e të parëve tanë, aty në pllajën e Pilingrisë. Do të kini mundësinë të njihni historinë e rrënjëve tona, të bëni foto e video, të krijoni kujtime të reja, dhe ndoshta të zbuloni pjesë të vetes që vetëm vendlindja mund t'jua rizgjojë.

Në këtë ditë do të shijoni gatime tradicionale bio, të përgatitura nga duar të dashura që dinë të ruajnë shijen e së vërtetës. Do të njiheni me punimet artizanale të grave të fshatit, që janë thesare të trashëguara me kujdes dhe përkushtim.

18 maji nuk është vetëm një piknik. Është një festë e jetës, një përqaftim i brezave, një këmbanë që na kujton se kush jemi dhe nga vijmë.

Ju presim me zemër të hapur! Kallarati ju mirëpret! Mos e lini këtë ditë të kalojë pa qenë pjesë e saj. Sepse aty ku ka dashuri për vendlindjen, ka jetë – ka të ardhme.

Kryesia e Shoqatës “Kallarati”



THIRRJE “PËR SPONSORIZIM TË KOSTUMEVE POPULLORE NË DITËN E PIKNIKUT PRANVEROR, MË 18 MAJ 2025 NË KALLARAT”

Data 18 maj 2025 po afron! Kjo është dita kur në Kallarat, në vendin e quajtur “Fshati i Djegur” ose “Kallarati i Djegur” do të organizohet edicioni i dytë i Piknikut Pranveror.

Vitin e kaluar, falë sponsorizimit të Leonard Stratit dhe Ksenofon Xhaferaj, u realizua marrja me qira e kostumeve popullore për grupin e burrave dhe të grave. Kostumet e traditës ndezën atmosferën, duke rikthyer hijeshinë e kulturës sonë në zemër të natyrës.

Po për këtë vit?

Pikniku po afron dhe ne synojmë ta bëjmë atë edhe më madhështor. Për këtë arsye, presim çdo dashamirës, biznesmen dhe jo vetëm, t'i bashkohet kësaj nisme. Çdo kontribut është një hap më afër ruajtjes së traditës dhe gjallërimit të atmosferës festive.

Bashkë mund ta bëjmë më të bukur!

Për të kontribuar financiarisht (për të dy grupet afërsisht 30 mijë lekë të reja), mund të kontaktoni direkt në komentet e këtij njoftimi, kryetarin e shoqatës z. Kastriot Karaboli ose në Messenger të Shoqatës Kallarati.

Kallarati ju falënderon për zemrën dhe dashurinë që tregoni!

Një kostum popullor nuk është thjesht një veshje; është historia e të parëve tanë, është fryma e Labërisë që rreh mbi supet tona. Duke kontribuar, nuk mbështet vetëm një ngjarje, por ruan një kujtim, ringjall një traditë dhe e përcjell atë me krenari tek brezat që vijnë.





KALLARATIN NUK E DUAN VETËM KALLARATASIT

Kallaratin nuk e duan vetëm kallaratasit. Dashuria për këtë fshat të vogël, por plot histori dhe krenari, përhapet si fllad mali anembanë, aty ku miqësia dhe respekti mbeten të përjetshëm. Kësaj here, mbështetja na vjen nga Tirana, nga Elida Keta, me origjinë të hershme nga Shëngjergji i Tiranës, një fshat malor që shquhet për bukurinë, mikpritjen dhe bujarinë e tij.

Si nisi kjo histori? Ishte një thirrje e hedhur në Facebook në profilin e Shoqatës “Kallarati”, një kërkesë për sponsorizimin e grupeve labe të burrave dhe grave, që do të këndonin në Piknikun Pranveror në “Fshatin e Djegur” të Kallaratit, më 18 maj 2025. Në mes të komenteve, një emër u shfaq me një premtim të thjeshtë e të sinqertë: Elida Keta. Me një fjali të shkurtër, ajo shprehu dëshirën për të qenë pjesë e sponsorizimit të grupeve me kostume kombëtare tradicionale. Elida Keta, një emër i panjohur, një fytyrë që nuk e kishim takuar kurrë, por që dëshironte të ndihmonte. Duke mos dashur të nxisim komente të shumta në Facebook, vendosa të bisedonim privatisht në Messenger. Kur e kontaktova, fillimisht u prezantova, se kush isha dhe cili ishte roli im në Shoqatën “Kallarati”. E pyeta pa hezitim: “Çfarë ju lidh me Kallaratin? A e dini ku bie?” Ishte një pyetje që e bëra me plot kureshtje për t’u siguruar se pas këtij premtimi qëndronte diçka më shumë se një koment kalimtar.

Përgjigjja e saj erdhi e ngrohtë dhe plot emocion: “Unë jam me origjinë nga Shëngjergji i Tiranës, me profesion ekonomiste e lartë, vetë jam lindur në Tiranë, por kam pasur burrin e hallës nga Kallarati, për të cilin kam pasur gjithnjë respekt dhe e kam dashur shumë”. Në atë moment ndjeva një ngrohtësi të veçantë; nuk ishte një emër anonim, por një person me një lidhje të sinqertë miqësie me Kallaratin. E pyeta më tej, me kureshtje të shtuar: Kush ishte burri i hallës? - Ai quhej Sami Karabolli - më tha Elida, duke shtuar me një zë plot mirënjohje se donte të kontribuonte për Kallarat sikur ta kishte kërkuar ai vetë (Samiu).

Një ndjesi e veçantë përshkoi bisedën tonë. Sami Karabolli, një emër i njohur për mua. Ai nuk ishte vetëm një bir i Kallaratit; ishte një burrë i veçantë, mësues dhe djalë dëshmor. Kam pasur fatin të punoj me të në Shkodër, të dy ushtarakë. Ai më i madh në moshë e me detyrë, por gjithmonë i dashur, me kulturë dhe shumë i respektuar. Njëkohësisht, m’u kujtua Shkodra e atyre viteve, ku Samiu njihej dhe nderohej për integritetin dhe mençurinë e tij. M’u kujtua gjithashtu nëna e tij, nënë Xheva, bashkëshortja Drita dhe vajza e tij, Entela. M’u kujtuan vizitat në shtëpinë e tij, drekat e darkat familjare me ta. M’u kujtuan vizitat, që në çdo 5 maj, kolegët do t’i bënin në kujtim të të atit dëshmor i atdheut, Shuko Karabolli, ku pjesë e këtyre vizitave do të isha edhe unë. Ishin njerëz të mirë, të dashur e të respektuar në çdo takim që kam pasur me ta. Shtëpia e tyre në Shkodër ishte një copëz “Kallarat”. Në atë moment, mesazhet me Elidën morën një tjetër dimension; nuk ishin më vetëm fjalë, por ura lidhëse mes dy fshatrave, Shëngjergjit dhe Kallaratit. Një kafe në qendër të Tiranës, duke ndjekur edhe etapën e dytë të “Giro d’Italia 2025”, e përforcoi edhe më shumë këtë miqësi. Biseduam gjatë për familjen e Sami Karabollit, për Kallaratin, për traditat, për ngjarjet historike dhe për Piknikun Pranveror që po afronte. Elida u bë pjesë e nismës, jo thjesht si një sponsorizuese modeste, por si mike e re e Kallaratit, që ndjeu se duhej të kontribuonte në nder të kujtimit të Sami Karabollit.

Kallaratin nuk e duan vetëm kallaratasit. Kallarati është një thesar i vlerave dhe traditave që frymëzojnë edhe ata që e njohin vetëm nëpërmjet miqësive dhe kujtimeve të paharruara.

Kallarati nuk është vetëm një fshat; është një frymë, një ndjesi që mbetet e gjallë te zemrat e të gjithëve që e prekin. Dhe Elida, me zemrën e saj të madhe, dëshmoi se dashuria për këtë vend të bekuar nuk njeh kufij.



PETRIT HABILAJ FINANCON PËR KOSTUMET POPULLORE TË GRUPIT TË GRAVE TË KALLARATIT

Petrit Habilaj nga Kallarati, aktualisht emigrant në Itali, iu përgjigj i pari thirrjes për sponsorizimin me 200 euro të marrjes me qira të veshjes së grave me kostume popullore në ditën e Piknikut Pranveror, që do të mbahet më 18 maj në “Fshatin e Djegur”. Një gjest i thjeshtë, por plot kuptim, që rikthen në vëmendje vlerat dhe krenarinë e traditës së pasur të Kallaratit.

Në një bisedë telefonike me Petritin, ai u shpreh: “Çdo njeri prej nesh ka detyrim moral, por edhe financiar ndaj vendlindjes. Si familje e ndjekim me shumë dashuri faqen e Facebook-ut të Shoqatës dhe aty mësojmë çdo lajm, çdo informacion në kohë reale që ka të bëjë me vendlindjen Kallaratin. Vlerësoj punën vullnetare dhe me pasion që bën kryesia e Shoqatës, sidomos në organizimin e aktiviteteve me karakter kulturor e patriotik.”

Petriti kujtoi ndërmjet të tjerash me nostalgji kohën kur ishte pjesë e grupit polifonik të fshatit: “Dikur kam qenë pjesë e grupit polifonik të fshatit dhe kur visheshim me kostumet popullore, ndjenim një krenari kombëtare. Prandaj, me shumë dëshirë, sa pashë thirrjen për sponsorizimin e veshjeve të grave të fshatit për ditën e Piknikut Pranveror, familjarisht u lidhëm me drejtuesit e Shoqatës për të kontribuar në këtë event kulturor të datës 18 maj.

Në pamundësi për të qenë të pranishëm,” – u shpreh më tej Petriti – “Uroj gjithë bashkëfshatarët e mi, ta kaloni sa më bukur. Aktivitete të tilla paçi gjithmonë,” – përfundon bisedën Petriti nga Italia.



Kryesia e Shoqatës “Kallarati” e falënderon Petritin dhe familjen e tij për këtë kontribut të vyer, që jo vetëm përforcon lidhjet me vendlindjen, por edhe ruan gjallë traditat tona kulturore.

Një shembull që tregon se, edhe në distancë, zemra rreh fort për rrënjët dhe identitetin e përbashkët.

Faleminderit Petrit! Kallarati të vlerëson!

SPONSORIZIM AKTIVITETI NË KUJTIM TË SAMI KARABOLLIT

Në thirrjen për mbështetje që Shoqata “Kallarati” bëri për blerjen e një fonie me vlerë 200 mijë lekë të vjetra, e para që u përgjigj ishte Drita Karabolli, me banim në Tiranë, bashkëshortja e Sami Karabollit (ndarë nga jeta) dhe vajza e tyre, Entela Karabolli, që jeton në Amerikë. Një gjest i thjeshtë, por i mbushur me dashuri dhe respekt për vendlindjen dhe kujtimin e njeriut të tyre të dashur.

Fonia e pajisur me dy mikrofone të lëvizshëm, me bluetooth, USB, funksionon me korent dhe me bateri të karikueshme. Ajo do të mbahet në administrim nga një banor i Kallaratit dhe do të shërbejë për çdo aktivitet kulturor dhe çdo ngjarje tjetër që shoqata “Kallarati” do të organizojë, qoftë në ambiente të mbyllura apo në terren të hapur, ku mungon energjia elektrike. Një zgjidhje praktike që do t’i japë zë çdo feste e çdo takimi.

Me këtë rast, kryesia e shoqatës “Kallarati” i shpreh mirënjohjen e saj të sinqertë Dritës dhe vajzës së saj, Entela Karabollit, për gjestin e tyre fisnik. Siç rrëfen Drita: “Samiu e deshi shumë Kallaratin. Kudo ku punoi, do të thoshte me krenari: ‘Jam nga Kallarati’. Këtë dashuri e mirënjohje për Kallaratin e kishte ngulitur edhe tek unë si bashkëshorte dhe aq më tepër te vajza, Entela. Samiu u nda para kohe nga jeta, në kohën që dëshironte të jepte kontributin e tij në shoqatën ‘Kallarati’. Prandaj, në kujtim të tij, ne vendosëm të kontribuojmë sado pak për shoqatën, pasi e ndjekim me dëshirë gjithë



aktivitetin e saj nëpërmjet rrjeteve sociale dhe ndihemi krenare për çdo arritje të saj, sidomos në ruajtjen dhe transmetimin te brezi i ri të ndjenjave patriotike dhe atdhetare,” – përfundon bisedën Drita Karabolli.

Ky gjest dëshmon edhe një herë se, dashuria për vendlindjen nuk shteron kurrë dhe se, kujtimet e atyre që nuk janë më, vazhdojnë të mbeten të gjalla përmes kontributeve të tyre, duke lënë gjurmë në zemrat e njerëzve.

Duke u larguar nga kafja, nga ky takim i ngrohtë me Dritën, në prani edhe të njerëzve të saj, çiftit nga Kallarati, Birçe e Resmie Ribaj - Drita uron të gjithë kallaratasit një piknik të suksesshëm më 18 maj në Kallarati.



VOGËLUSHI NGA KALLARATI, PJESËMARRËS NË EDICIONIN E PARË DHE TË DYTË TË PIKNIKUT PRANVEROR NË “FSHATIN E DJEGUR”.

Kushedi në sa e sa edicione, ky dhe moshatarët e tij, do të marrin pjesë?

Të jeni të sigurtë se, brezi i ri do të ruajë traditat dhe zakonet e fshatit tonë dhe do t’i përcjellë ato brez pas brezi, ashtu siç bën brezi ynë sot dhe siç kanë bërë brezat e mëparshëm me ne.

NË PINIKUN PRANVEROR MBIZOTËRUAN KOSTUMET POPULLORE

Pikniku Pranveror në Fshatin e Djegur, organizuar nga Shoqata Kallarati, është një shembull i mirë i ruajtjes së traditave dhe forcimit të lidhjeve mes njerëzve. Veshja me kostume popullore tradicionale të Labërisë, në këtë rast, është një shprehje e nostalgjisë për të kaluarën dhe një mirënjohje ndaj rrënjëve tona kulturore. Këto takime jo vetëm që mbajnë gjallë historinë dhe kulturën e vendit, por edhe krijojnë momente të çmuara solidariteti e bashkimi mes njerëzve.

GATIMET TRADICIONALE

Në Piknikun Pranveror të organizuar në “Fshatin e Djegur”, mes tingujve të këngës dhe ritmit të muzikës, shijuar edhe gatimet tradicionale, përgatitura me mjeshtëri nga duart e nënave dhe motrave tona. Ulur në tapetin e blertë të natyrës, atmosfera e ngrohtë dhe mikpritëse krijoi një harmoni të veçantë mes brezave, duke rikthyer në kujtesë traditat dhe vlerat që na bashkojnë.



FEMIJET KALLARATAS - ZBUKUROJNE PIKNIKUN

Më 18 maj 2025, fëmijët kallaratas iu bashkuan Piknikut Pranveror të organizuar në Kallarat, një aktivitet që tashmë është kthyer në një traditë të bukur për komunitetin. Ky event nuk është thjesht një festë pranverore, por një moment ku brezat më të rinj kujtojnë dhe nderojnë ata që sakrifkuan jetën për lirinë dhe mbrojtjen e atdheut. Në këtë ditë të veçantë, fëmijët bene foto prane lapidarit ne qender te fshatit, por edhe ne ta e ne Fshatin e Djegur ne nderim te atyre qe dhane jeten ndaj sulmeve te andarteve grek ne korrik 1914. Pjesëmarrja e fëmijëve në këtë aktivitet përçon një mesazh të rëndësishëm për ruajtjen e vlerave kombëtare dhe forcimin e ndjenjës patriotike. Duke u rritur me këto ideale, ata mësojnë të vlerësojnë sakrificat e të parëve dhe të mbajnë gjallë kujtesën për ata që luftuan për liri e dinjtet. Fëmijët kallaratas, me praninë dhe përkushtimin e tyre, janë dëshmia më e bukur se traditat dhe vlerat e këtij fshati do të vazhdojnë të jetojnë gjatë në kohë.



PILINGRI - TOKË QË FLET ME ZEMËR

Anxhela Hysaj (moderatore e disa takime të brezave) përshëndeti pjesëmarrësit në Piknikun Pranveror me një poezi të shkruar enkas për piknikun nga Elena Memushaj.

Poezia "Pilingri: Tokë që flet me zemër" është një himn ndjenjash për vendlindjen, që përshkruan me ndjeshmëri takimin e brezave në një tokë të shenjtëruar nga historia dhe kujtimi. Autorja Elena Memushaj shpalos mallin, dashurinë dhe krenarinë për Pilingrinë – një vend që, ndonëse ka përjetuar dhimbje e shkatërrim, jeton në zemrat e bijve të tij. Përmes figurave të gjalla poetike dhe një gjuhe të ngrohtë, poezia ndërthur të kaluarën heroike me gëzimin e sotëm, duke përcjellë një premtim të përjetshëm për ruajtjen e lidhjes me rrënjët. Një poezi e thjeshtë në formë, por e thellë në mesazh.

PILINGRI: TOKË QË FLET ME ZEMËR

Në gjirin tënd sot prapë jemi mbledhur,
me këngë, me valle, me mall të pashterur.
Nga larg e nga afër kemi ardhur me gaz,
të shuajmë një etje që s'ka kohë as fazë.
Fshat i djegur, por kurrë i harruar,
zemra e historisë, nga gjaku ngjyruar.
Në çdo gur, në çdo pemë që rri në heshtje,
ka zëra që thërrasin:

"Ne jemi pjesë e kësaj jete!"

Këtu ku dikur zjarri e flaka s'u ndal,
sot ndizet gëzimi, me dashuri pa fjalë.
Bashkëfshatarë, miq e shokë në një rreth,
si gjethe e si erë që s'ndalet me kohë e me vjet.
Pilingri – emër që zemrën na prek,
ti je kënga jonë, në festë dhe në jerm.
Të premtojmë sot, në këtë diell që na ndriçon,
se brez pas brezi, do të rrimë
bashkë gjithmonë!



PILINGRI: TOKË
QË FLET ME
ZEMREN
Teksti: Elena
Memushaj
Reciton:
Anxhela Hysaj

IRISI E VOGËL, PËRFAQËSUESE E BREZIT TË KATËRT TË HYSO XHAFERAJ, VIZITON PËR HERË TË PARË KALLARATIN

Irisi e vogël është vajza e Alvaro Xheferajt dhe erdhi për herë të parë në Kallarat, në vendlindjen e babait të saj në ditën e zhvillimit të Piknikut Pranveror, më 18 maj 2025. Por ajo që e bën edhe më të veçantë këtë vizitë është se Irisi vjen në fshatin ku ka lindur gjyshi i saj, "Bilbili i Labërisë", i paharruari Hyso Xhaferaj. Ajo viziton gjithashtu fshatin e stërgjyshit të saj, Balil Xhaferaj, një emër mjaft i njohur dhe i vlerësuar për Kallarat.

Irisi vjen edhe si përfaqësuese e brezit të katërt të dëshmorit të vitit 1914, Hyso Xhaferaj. Ajo është krenare për Hyson e parë, që me pushkën e tij kundër andartëve grekë së bashku me katër të tjerë dha jetën për mbrojtjen e fshatit, dhe po aq krenar për Hyson e tanishëm, që nuk u bë i njohur me pushkë, por me zërin e tij, një zë që kumbonte si pushkë nëpër skenat shqiptare dhe ato ndërkombëtare.

Prandaj, duke ardhur për herë të parë në Kallarat dhe në Piknikun Pranveror, Irisi nuk mund të mos ndalonte për të bërë një foto pranë pemës së mbjellë në Morrez, në kujtim të gjyshit të saj këngëtar, Hyso Xhaferaj, më 1 mars, "Ditën e Pylëzimit", si dhe një tjetër në "Fshatin e Djegur", pranë lapidarit të dëshmorëve të rënë më 1914 në luftë me andartët grekë.

Dy fotot e Irisit janë mjaft domethënëse. Ato lidhin dy kohë dhe tregojnë se dashuria për Kallarat dhe për njerëzit e shtrenjtë do të trashëgohet brez pas brezi, jo vetëm tek brezi i katërt, siç është Irisi, por për shekuj me radhë.





Midis nesh në Piknikun Pranveror edhe ish kryetari i Komunës së Horë - Vranishtit dhe miku i Kallararit, z. Simbol Pazaj



JOELA JETNOR JONUZAJ

Joela ëndërron të bëhet një prezantuese në të ardhmen, jo vetëm për festat e kallararit, por më tepër, pse jo edhe një aktore. suksese joela, ëndërrat t'u bëfshin realitet.



FAMILJA DAUTAJ ME BANIM NË DURRES, E PRANISHME NË ÇDO AKTIVITET TË SHOQATËS KALLARATI

Si çdo vit, edhe këtë herë familja Dautaj me origjinë nga Kallaratit e banim në Durrës ishte pjesë e Piknikut Pranveror në "Fshatin e Djegur", duke realizuar edhe një foto simbolike pranë Lapidarit të Dëshmorëve.

Kjo familje, e përbërë nga disa breza – nga fëmija më e vogël deri te stërgjyshi Abaz Dautaj (i cili kësaj radhe për arsye moshe e shëndetësore nuk ishte i pranishëm) – është e njohur për pjesëmarrjen e pandërprerë në çdo aktivitet të Kallararit.

Përveç pranisë së tyre aktive, ata kontribuojnë edhe me investime konkrete, siç ishte rasti i vitit të kaluar me financimin e ndriçimit të qendrës së fshatit.

Mirënjohje e veçantë për këtë familje, që ruan e përcjell me përkushtim vlerat historike dhe patriotike brez pas brezi!



ISH MËSUESIT VIRON AVDULI DHE NEZINET LESKAJ TË PRANISHËM NË PIKNIKUN PRANVEROR

Në këtë Piknik pranveror përveç kallaratasve pati edhe pjesëmarrës të tjerë jo kallaratasi por të lidhur shpirtërisht me të. Ndër ta spikasin dy figura të dashura dhe të vlerësuara nga të gjithë kallaratasit – jo vetëm në këtë piknik, por edhe në ngjarje të tjera të rëndësishme të fshatit, si festimi i 100-vjetorit të çeljes së shkollës së parë shqipe në vitin 2016, kur me propozim të kryesisë së Shoqatës "Kallaratit", të dyve u është akorduar Certifikata e Mirënjohjes: "Për kontributin e dhënë në fushën e mësuesisë dhe edukimin e brezit të ri", dhënë nga Këshilli i Bashkisë së Himarës. Bëhet fjalë për mësuesit Nezinet Leskaj, bijë nga Bolena, dhe Viron Avduli nga Tragjasi, të cilët pas viteve '70 ishin edukatorë të brezave në shkollën 8-vjeçare "Mumin Selami", ku lidhën edhe jetën e tyre bashkëshortore. Sot, me përkushtimin e tyre të pashuar, ishin pjesëmarrës në këtë festë të bukur. Fjalët e tyre përshëndetëse sollën shumë emocione. Ata kujtuan me dashuri mikpritjen kallaratase, sollën kujtime të bukura nga koha e shkollës dhe jeta kulturore e fshatit. Si shumë intelektualë të rinj të atyre viteve, edhe ata ishin pjesë e pandarë e gjallërisë dhe entuziazmit rinor që e karakterizonte Kallaratin.



REJIONI I VOGËL, POR ME RRËNJË TË MËDHA...

Ky vogëlush i ëmbël, Rejioni, lindur në Tiranë, djali i Besard e Juljana Beriollit, stërnip në Kosovë dhe në Kallarat, mori pjesë në Piknikun Pranveror në fshatin e gjyshes së tij, aty ku historia flet dhe zemra ndien më fort. Me hapa të vegjël, por me shpirt të madh Rejioli, ndaloi për një çast para lapidarit të dëshmorëve, për të bërë një foto aty ku është skalitur edhe emri i Hyso Xhaferajt – dëshmorit të vitit 1914, gjyshit të gjyshes së tij, Vojsava Beriollit (Xhaferaj).

Ky çast i thjeshtë, por thellësisht domethënës, na kujton se rrënjët nuk harrohen. Lidhja me të kaluarën trashëgohet me dashuri dhe përkushtim, ndërsa kujtimi i të parëve mbetet i gjallë në sytë e pastër të brezit të ri.

Faleminderit, Rejion i dashur, që me praninë tënde pranë lapidarit na kujtove se historia jonë jeton përmes fëmijëve tanë, dhe se dashuria për vendlindjen është një thesar që kalon nga zemra në zemër.





FALEMINDERIM GJITHË ATYRE QË BËNË TË MUNDUR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PIKNIKUT PRANVEROR NË “FSHATIN E DJEGUR”, KALLARAT MË 18 MAJ 2025

Me rastin e organizimit dhe të zhvillimit të suksesshëm të Piknikut Pranveror në Kallarat më 18 maj 2025, kryesia e shoqatës ju shpreh falënderim të përzemërt gjithë pjesëmarrësve dhe gjithë atyre që me përkushtim dhe dashuri kontribuan në përgatitjen dhe realizimin e këtij aktiviteti tradicional, duke e bërë atë një ditë të paharrueshme për të gjithë.

Mirënjohje e veçantë shkon për të gjithë pjesëmarrësit – banorët e Kallaratit dhe të ardhurit nga Vlora, Fieri, Durrësi, Tirana e më gjerë, miq dhe dashamirës të fshatit tonë që u bashkuan në këtë festë të bukur.

Faleminderit organizatorëve të shoqatës Kallarati dhe Këshillit të fshatit, që me përkushtim dhe bashkëpunim arritën të sjellin një organizim të shkëlqyer dhe frymë bashkimi.

Faleminderit sponsorizuesëve të kostumeve popullore tradicionale Petrit Habilaj dhe Rexhi Mataj dhe të fonisë Drita e Entela Karabollit, që e bënë këtë ditë më të gjallë dhe plot ngjyra.

Faleminderit fëmijëve që me veshjet e tyre tradicionale e zbukuruan edhe më tepër këtë takim, duke përcjellë me krenari trashëgiminë tonë.

Faleminderit grupit të burrave dhe grave për këngët e kënduara me shpirt dhe emocion.

Mirënjohje për ata që punuan në përgatitjen e grupeve të këngës labe, duke mbajtur gjallë këtë traditë të vyer.

Faleminderit moderatores së takimit Elena Memushaj për drejtimin me kompetencë dhe përcimin e mesazheve të bashkimit dhe patriotizmit.

Faleminderit të gjithë atyre që përcollën mesazhe nga mikrofoni, duke na kujtuar dashurinë dhe krenarinë për vendlindjen.

Faleminderit fëmijëve që me vetëdije vendosën lule pranë lapidarëve të dëshmorëve, duke nderuar kujtimin e tyre.

Faleminderit grave që ekspozuan punimet artizanale, duke treguar mjeshtërinë dhe traditën e tyre.

Faleminderit banorëve që me makinat e tyre ndihmuan falas të moshuarit për t'u ngjitur në Fshatin e Djegur, duke treguar solidaritet dhe mirënjohje ndaj tyre.

Faleminderit grave, nënave dhe motrave tona që përgatitën e servirën me dashuri gatimet tradicionale, duke sjellë shijen dhe aromën bio.

Faleminderit burrave dhe djemve që deri në orët e vona të mbrëmjes u angazhuan në përgatitjen e dekorit të vendit të zhvillimit të Piknikut Pranveror në “Fshatin e Djegur”.

Faleminderit gjithë atyre të rinjve, por jo vetëm, që publikuan foto dhe video në rrjetet sociale, duke i dhënë jehonë dhe emocion kësaj feste.

Faleminderit gjithë atyre që me këngët, vallet dhe recitimet e tyre i dhanë vlerë, entuziazëm dhe gëzim takimit.



Faleminderit Bashkisë Himarë që na mbështeti në përmirësimin e rrugës për në Fshatin e Djegur. Dhe një falënderim i veçantë për Zotin, që na dhuroi një ditë me diell dhe ngrohtësi.

Kjo ditë tregoi edhe një herë se, së bashku, ne mund të ruajmë dhe përcjellim me krenari traditat tona, duke i mbajtur të gjalla për brezat e ardhshëm.

Takimi i Brezave i 16 gushtit të këtij viti që po afron, le të jetë një mundësi tjetër bashkimi e takimi me njëri-tjetrin, përfshi edhe emigrantët tanë në Greqi, Itali e kudo tjetër.

Me mirënjohje të thellë, Kryesia e shoqatës “Kallarati”



BESNIK GJONBRATAJ

Më 18 maj 2025, "Fshati i Djegur" në Kallarat, i gjendur në një cep të lashtë të Labërisë, ku historia nuk është vetëm e shkruar, por edhe e gdhendur në gurë, u mbush me jetë, zëra, ngjyra dhe muzikë. Në këtë vend që mban në gjoks plagët e së kaluarës, por edhe krenarinë e qëndresës, u zhvillua edicioni i dytë i Piknikut Pranveror, një organizim i Shoqatës Kulturore dhe Atdhetare "Kallارات", që me çdo aktivitet të tillë mbjell dashuri për vendlindjen dhe frymë bashkimi ndër breza.

Që në mëngjes, rrua drejt Pilingrisë, rrëzë malit të Bogonicëc, u kthye në një pelegrinazh, që gumëzhinte nga zërat plot emocione të pjesëmarrësve. Malet rreth e qark, si rojtarë të heshtur të së shkuarës, shikonin një vend që dikur u dogj, por që sot rilindte si një lulëzim i pandalshëm i kujtesës dhe krenarisë. Në këtë vend të shenjtë u mbledhën dhjetëra kallaratas nga Vlora, Fieri, Durrësi, Tirana e më gjerë – vendas të kthyer te rrënjët dhe miq që e kanë për zemër këtë fshat të bukur e me histori të lavdishme.

Atmosfera në këtë ditë ishte magjike: qielli i kthjellët si premtim i mirë, aroma e luleve dhe e barit të njomë, zërat e fëmijëve që vraponin me veshje tradicionale nëpër gurët e vjetër të fshatit dhe muzika që kumbonte nga fonia e re – një dhuratë simbolike e Dritës dhe Entelës, në kujtim të të ndjerit Sami Karabolli, mësues dhe ushtarak me rrënjë nga ky fshat.

Aktiviteti u hap me Himnin Kombëtar, përpara një flamuri që përplasej me krenari mbi "Ballkonin e Fshatit të Djegur". Moderatorja Elena Memushaj, me zërin e saj të qetë e të ëmbël dhe me emocionin që nuk fshihej dot, përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit: banorë të përhershëm të fshatit, emigrantë të kthyer për një ditë, dhe miq të dashur të Kallaratit.

Në fjalën e saj, ajo falënderoi ata që ndihmuan me zemër e shpirt për realizimin e kësaj dite: familjen e të ndjerit Sami Karabolli për blerjen e fonisë, z. Petrit Habilaj e Rexhi Mataj për sponsorizimin e kostumeve popullore dhe znj. Elida Keta nga Tirana për mbështetjen simbolike, frymëzuar nga miqësia e vjetër me këtë fshat.

Duartrokitjet shpërthyen shpesh, jo vetëm si mirënjohje, por edhe si një jehonë krenarie që e bashkonte këtë komunitet të mrekullueshëm.

Më pas, z. Besnik Gjonbrataj, në emër të kryesisë së shoqatës, bëri një përshëndetje të veçantë, mbushur me emocion. Ai foli për qëndresën historike të banorëve të Kallaratit ndaj andartëve grekë në korrik të vitit 1914, për djegien dhe plaçkitjen e fshatit, për aktin heroik të dëshmorëve të rënë në këtë luftë dhe nevojën që "Fshati i Djegur", kjo "Trojë e



“NË GJURMËT E SË KALUARËS, LULËZON E ARDHMJA”



Vogël Labe”, të shpallet “Qendër Historike”, si një simbol i pathyeshëm i kujtesës kombëtare, që do të shërbejë edhe për zhvillimin e turizmit kulturor malor. Ai vlerësoi kontributet materiale, shpirtërore dhe organizative të banorëve e miqve të Kallaratit, dhe përmbylli fjalën e tij me një thirrje që rezonojë me zemrat e të gjithëve: “Të mos harrojmë asnjëherë rrënjët tona dhe ta bëjmë Kallaratin më të bukur për brezat që vijnë.”

Prania e të moshuarve ishte një tjetër dritë e kësaj dite. Ata, me hapa të ngadaltë, por zemër të madhe, sfiduan moshën dhe rrugën për të qenë aty, në vendin ku gjithçka kishte nisur.

Ndër ta spikasnin dy figura të dashura dhe të vlerësuara nga të gjithë kallaratasit – jo vetëm në këtë piknik, por edhe në ngjarje të tjera të rëndësishme të fshatit, si festimi i 100-vjetorit të çeljes së shkollës së parë shqipe në vitin 2016, kur me propozim të kryesisë së Shoqatës “Kallارات”, të dyve u është akorduar Certifikata e Mirënjohjes: “Për kontributin e dhënë në fushën e mësuesisë dhe edukimin e brezit të ri”, dhënë nga Këshilli i Bashkisë së Himarës. Bëhet fjalë për mësuesit Nezinet Leskaj, bijë nga Bolena, dhe Viron Avduli nga Tragjasi, të cilët pas viteve ’70 ishin edukatorë të brezave në shkollën 8-vjeçare “Mumin Selami”, ku lidhën edhe jetën e tyre bashkëshortore. Sot, me përkushtimin e tyre të pashuar, ishin pjesëmarrës në këtë festë të bukur. Fjalët e tyre përshëndetëse sollën shumë emocione. Ata kujtuan me dashuri mikpritjen kallaratase, sollën kujtime të bukura nga koha e shkollës dhe jeta kulturore e fshatit.



Si shumë intelektualë të rinj të atyre viteve, edhe ata ishin pjesë e pandarë e gjallërisë dhe entuziazmit rinor që e karakterizonte Kallaratin. Atmosfera e ditës mori jetë nga grupet artistike të grave dhe burrave, të cilët, të

veshur me kostume popullore, sollën jehonën e melodive të hershme të këngës labe dhe valleve të jugut. Në çdo tingull dhe lëvizje rrihte zemra e traditës. Këngët për trimërinë, për nënën, për dashurinë dhe për vendlindjen, të kënduara



me shpirt nga Bejazja, Andoni, Elena, Mazeta e të tjerë, nuk ishin thjesht interpretime – ishin rrëfime të gjalla, histori që këndoheshin me ndjenjë e malli. Një ndër momentet më prekëse ishte interpretimi i poezisë “Pilingri, tokë që flet me zemër” e autores Eleni Memushaj, recituar me shumë emocion nga vajza kallaratase Anxhela Hysaj. Zëri dhe ndjenja e saj i dhanë jetë fjalës së shkruar, duke prekur zemrat e të pranishmëve. Yjet e padiskutueshëm të ditës ishin fëmijët – të veshur me kostume tradicionale. Ata ishin mishërimi i shpresës për vazhdimësinë e trashëgimisë. Me natyrshmërinë e tyre, u përfshinë në këngë e valle krah të rriturve, vendosën buqeta me lule dhe bënë foto pranë lapidarëve të dëshmorëve – si në qendër të fshatit në Morrez, ashtu edhe në Fshatin e Djegur. Ato gjeste të vogla, por plot kuptim, dëshmonin se rrënjët e së kaluarës janë të gjalla dhe se brezi i ri po rritet me respekt për historinë dhe me dashuri për origjinën. Një tjetër moment i veçantë i këtij pikniku

pranveror ishte panairi i punimeve artizanale të grave kallaratase. Qëndisma, punime me grep e në tezgjah, të punuara me dashuri, ishin ekspozuar në lëndinën e Pilingrisë, duke treguar se shpirti krijues i gruas labe nuk është shuar asnjëherë. Pas panairit, shumë pjesëmarrës bënë një shëtitje në trojet e të parëve, shtëpitë e dikurshme të shkrumbuara, themelet që ende duken, rrënojat që rrëfejnë histori pa fjalë. Aty, çdo hap ishte një kapitull i lexuar me zemër. Pikniku kulmoi me një drekë të përbashkët në natyrë, në fushën pranë lapidarit. Dikush



kishte sjellë bukën me vete, dikush tjetër shijonte gatimet tradicionale që nënat dhe motrat kallaratase kishin përgatitur me dashuri: byrekët që shkrinin në gojë, arapashi që të ngopte shpirtin dhe revania që i jepte ëmbëlsi këtij takimi, pa harruar edhe mishin e pjekur, shoqëruar me një gotë raki a birrë. Mbi sofrat e shtruar në barin e njomë ndaheshin histori, kujtime e plane për takimet e ardhshme. Në fund të këtij organizimi të shkëlqyer, kryetari i Shoqatës “Kallarati”, z. Kastriot Karabolli, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, theksoi se më 16 gusht 2025, Kallarati do të presë një tjetër aktivitet të rëndësishëm: “Takimin e Brezave”, që do të sjellë bashkërisht kallaratas brenda dhe jashtë Shqipërisë, për të kaluar një mbrëmje të këndshme mes këngëve dhe valleve popullore – një natë që bashkon të gjithë brezat. Pikniku u mbyll me ftesën për një foto të përbashkët – një simbol i unitetit dhe i një komuniteti që, pavarësisht distancave, është i bashkuar përmes motos: “Ec ngado, por Kallaratin mos e harro!”



Takimin e Brezave – sepse Kallarati nuk është vetëm një vend, është një ndjenjë që nuk do të shuhet kurrë. Botuar në gazetën “Destinacioni”

KRIJIME NGA ELENA MEMUSHAJ

Mali Bogonicë
Kurora e Zotave

Mbi Kallaratin, si mbret në fron,
ngrihet Bogonica, mal i shenjtë, i jon'.
Me ballin në re, me këmbët në Shushicë,
ruan legjendat, si flakë në qiri të fisnikës.

Mali i Zotave, thërritet me nder,
ku era flet me gjuhë të vjetër dhe të vërtetë.
Luginat i puthin hijen e tij të rrallë,
nën shkëmb e lis, historia rron e gjallë.

Kallarati: fshat i vogël, por me zemër të madhe,
prej brezash që nuk i trembi as plumbi, as balta e thatë.
Në rrënjë të tij, pushon gjaku ynë fisnor,
me këngë, me djepa dhe gurë kujtimor.

Shushica, si fustan i argjendtë që rrëshqet,
i jep jetë çdo degë, çdo fjalë që rri pezull në retë.
Ujë e saj këndon ndër çezma, ndër shpirt,
si ninullë e nënës që kurrë nuk vdes, por rrit.

Bogonicë, ti kurorë e lavdisë së një kohe,
ku Zoti e vendosi hijeshinë mbi troje.
Ti flet pa zë, por zemrat i dridh,
si një amë e lashtë që ende na mban gjallë me shpirt.



Lumi Shushicë

Lumi Shushicë me ujë kristali,
më zgjon kujtimet si erë mali.

Kur më prek, më ngjall një mall,
atë mallin e hershëm që s'fiket vallë.

Për hir të bukurisë që mbart,
nis të thurë vargje me shpirt të artë.

Nga malet e Kuçit buron me fllad,
e fshatrat përshkon me nur të madh.

Si gjarpër i argjendtë dredhon me hijeshi,
kush pi nga ti, bekon jetën në përjetësi.

Ti përshkon Labërinë e lavdisë,
ku rrjedh gjaku i trimërisë.

Shushicë, me ujë të bekuar,
sa e sa zemra të kanë kënduar!

Të dy anët të zbukurojnë plot gjelbërim,
me rrepe, me shelqe, filiza barishte për dekorim.

Më kujton fëmijërinë në brigjet e tua,
ku freskoheshim në ditë të nxehta e dimrit
na frikësoje kur bashkoheshe me përrua.

Me gurgullimën tënde u rrita ngadalë,
e shpirti aty më mbeti i gjallë.

Shtëpia ime mbi ty lartëson,
E kush lindi pranë teje, i bekuar jeton!





**11 MAJ 2025, 180 ÇIKLISTËT MË TË MIRË TË BOTËS, NË ETAPËN E TRETË
GARUAN PËRGJATË RRUGËS AUTOMOBILISTIKE TË LUMIT TË VLORËS,
DUKE PËRSHKRUAR PËR DISA MINUTA EDHE KALLARATIN**



SHOQATA "KALLARATI" - BILANCI I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2025 DHE AKTIVITETET KRYESORE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT NË VIJIM

Në fillim të janarit 2025, Shoqata Atdhetare dhe Kulturore "Kallاراتi" shpalli programin e saj vjetor, duke u zotuar se edhe këtë vit do të vijojë të jetë ura që lidh brezat, mban gjallë traditat, ruan kujtesën historike dhe forcon dashurinë për vendlindjen. Me përkushtim, vullnet dhe dashuri për fshatin tonë, Shoqata ka realizuar një sërë aktivitetesh të rëndësishme.

**ÇFARË U REALIZUA ME SUKSES
GJATË KËTIJ GJASHTËMUJORI:**



7 MARS – DITA E MËSUESIT

Në këtë ditë të shënuar, Shoqata ka përcjellë mesazhe mirënjohjeje dhe vlerësimi për mësuesit, ata që mbollën dijen dhe formuan brezat. Janë kujtuar me respekt mësuesit e parë të fshatit, ata që hapën rrugën e dijes, por edhe mësuesit e sotëm që vijojnë me përkushtim këtë mision fisnik.



8 MARS – FESTA E NËNËS

Me rastin e Festës së Nënës, Shoqata ka përcjellë urime dhe mesazhe të ngrohta për gratë dhe nënat kallaratase, shtyllat e familjes dhe të shoqërisë sonë. Në Kallarat, gratë organizuan një drekë festive ku morën pjesë të gjitha gratë që jetojnë në fshat, duke treguar forcën e bashkimit dhe të traditës.



5 MAJ – DITA E DËSHMORËVE

Në këtë ditë të rëndësishme, janë zhvilluar homazhe pranë Lapidarit në qendër të fshatit, duke nderuar kujtimin e dëshmorëve të Kallaratit dhe të gjithë Kurveleshit. Kallaratasi që jetojnë në qytete të ndryshme kanë marrë pjesë edhe në veprimtaritë përkujtimore që janë organizuar aty ku ata banojnë, duke mos harruar kurrë rrënjët dhe sakrificat.



PIKNIK PRANVEROR NË "FSHATIN E DJEGUR"
PROMOVOJMË VLERAT HISTORIKE,
KULTURORE DHE TURISTIKE TË KALLARATIT



PIKNIKU PRANVEROR – 18 MAJ NË "FSHATIN E DJEGUR"

Një aktivitet i mbushur me jetë, me pjesëmarrje të gjerë të kallarataseve nga fshati dhe qytetet, si dhe nga emigracioni. Ky piknik u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë, me muzikë, valle, biseda dhe aktivitete argëtuese, duke sjellë edhe njëherë në vëmendje historinë e Fshatit të Djegur dhe rëndësinë e kujtesës.



NISMA PËR GJELBËRIMIN E FSHATIT "MBILL EDHE TI NJË PEMË NË VENDLINDJE"

Në vijim të nismës "Mbill edhe ti një pemë në vendlindje", janë mbjellë dhjetëra pemë dekorative dhe lule, kryesisht pranë Lapidarit, përgjatë përroit të Morrezës, në Qafën e Ubavit dhe përgjatë rrugës automobilistike që përshkon fshatin. Një nismë që po i jep fshatit pamje më të bukura dhe më të gjalla.

KALLARATI

Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGANI PERIODIK I SHOQATËS E / A "KALLARATI"
Viti 120-të i botimit, nr. 194, janar – mars 2025.
Çmimi 50 L. Webfaqja: www.kallarati.com.

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lutfi Myzeq
Ky numër u sponsorizua nga:
Besnik Gjoniçaj

BRIGADA V SULMUESE DHE KALLARATASIT NË PËRBERJE TË SAJ

Brigada e Frontit Sulmues u përbërë në 30 janar 1944 në Bazarë të Tërfaqit, rrethi i Vlorës, me një efekt prej 500 partizanësh të armatosur në përballje me forcat e pushtetit të ashpër italian. Brigada e Frontit Sulmues u formua në 28 shtator 1943 në fshatin Qendër të Vlorës. Kjo brigadë shpesh shpesh luftoi dhe bëri lufte të ashpër, nga ajo që në vitin e parë të luftës. Në Brigadën e Frontit Sulmues u përbërën më 7 janar, nga 10 çetë 4 ditë jetë dhe u shpesh detyruar të luftojnë...



Page 3

LUMI I VLORËS, KY DET PASURISH KOMBËTARE



Page 4

GËZUAR 7 MARSIN, "DITËN E MËSUESIT"!



PROFESOR ARDIT BIDO I BASHKOHET NISMËS SONË



Shoqata "Kallarati" dhe të gjithë kallaratasit shprehin mirënjohjen e tyre më të theksuar për kontributin e arditit në shoqatë. Profesor Dr. Ardit Bido jo vetëm që mbështetjen e tij politike dhe ndaj qendrës mbarëkombëtare dhe kontributit të tij në rritjen e bashkësisë së kallaratas, në mënyrë të veçantë qëndruan në vitin 1984, por edhe për atë që gjatë viteve të kaluara në kushte të vështira "të luftës" dhe "të jetës" dhuroi një pjesë...

TË NJOHIM KALLARATASIT BRENDA E JASHTË VENDIT

Page 7

GAZETA "KALLARATI" ka vijuar rregullisht botimin. Deri tani janë botuar dy numra të gazetës për vitin 2025, ndërsa po punohet për përgatitjen e numrit të tretë. Gazeta është kthyer në një pasqyrë të aktiviteteve të shoqatës, të historisë, të traditave, si dhe një mënyrë për të forcuar lidhjen mes kallaratasve kudo ku ndodhen.



Shoqata Kallarati

FAQJA E SHOQATËS NË FACEBOOK

ka qenë aktive çdo ditë. Përmes kësaj faqeje janë përcjellë:

- Urime për ditëlindjet e çdo bashkëfshatari, kudo që ai ndodhet.
- Njoftime për ndarjet nga jeta, shoqëruar me fjalë ngushëllimi dhe solidaritet me familjet e prekura.
- Postime që ruajnë kujtesën historike për ngjarje të shënuara të historisë së Kallaratis dhe Kurveleshit.
- Përvjetorë të brigadave sulmuese dhe përkujtim i kontributit të kallaratasve në to.

PUNA PËR PËRGATITJEN E HISTORIKUT TË KALLARATIT ËSHTË DREJT PËRFUNDIMIT

Nën drejtimin e profesor Rami Memushaj, grupi i punës ka avancuar ndjeshëm me përgatitjen e këtij botimi të rëndësishëm. Me mbështetjen financiare të bashkëfshatarëve, ky libër do të dalë në dritë brenda gjashtëmujorit të dytë të këtij viti, duke lënë një trashëgimi të çmuar për brezat e ardhshëm.

ÇFARË NUK ËSHTË REALIZUAR ENDE, POR MBETET DETYRIM PËR T'U REALIZUAR:

- RIVENDOSJA E PLLAKËS PËRKUJTIMORE, përgatitur nga gurgdhendësi Agim Mataj me vargjet "Kallarati, Kuç e Bolenë, në lum' ç'e zunë dyfeknë". Plaka me vargjet është menduar si një simbolikë që përjetëson bashkimin dhe qëndresën historike të fshatrave tona. Ajo mbetet ende për t'u realizuar dhe duhet të marrë jetë sa më parë.



- ORGANIZIMI I KONKURSTIT TË KRIJIMTARISË KUSHTUAR VENDLINDJES Ky konkurs, që synon të nxjerrë në pah talentin letrar të të rinjve dhe komunitetit, është menduar të nxisë dashurinë për fshatin dhe të forcojë ndjenjën e përkatësisë. Për arsye organizative nuk u realizua në këtë gjashtëmujor, por është një objektivi i afërt.

- PËRMBYLLJA E DOKUMENTACIONIT PËR PROPOZIM PËR SHPALLJEN E "FSHATIT TË DJEGUR" SI QENDËR HISTORIKE

Edhe pse puna për këtë proces ka filluar, ajo nuk është përfunduar ende. Ky është një hap me rëndësi të madhe për të ruajtur dhe vlerësuar historinë dhe kujtesën kolektive të komunitetit tonë.



RIORGANIZIMI I DEGËVE TË SHOQATËS KALLARATI NË RRETHE.

FOKUSI TASHMË ËSHTË DREJT TAKIMIT TË BREZAVE MË 16 GUSHT 2025!

Ky është aktiviteti më i rëndësishëm i vitit, një festë e rrënjëve, e kujtesës dhe e dashurisë për vendlindjen. Takimi i Brezave bashkon të gjithë kallaratasit, kudo që ata ndodhen, në një mbrëmje të mbushur me emocion, mall dhe krenari.

Kryesia e Shoqatës është e angazhuar maksimalisht për të organizuar një mbrëmje sa më dinjitoze dhe të paharrueshme për të gjithë:

- Po punohet për përgatitjen e një programi festiv, ku do të ndërthuren fjalimet përshëndetëse, kujtimet historike dhe momentet artistike.
- Është në proces sigurimi i një grupi të mirë muzikor dhe një këngëtar profesionist, që do t'i japë mbrëmjes hijeshi dhe atmosferë të veçantë.

THIRRJE PËR TË GJITHË BASHKËFSHATARËT DHE MIQTË E KALLARATIT:

Për të garantuar një mbrëmje të paharruar dhe një program artistik dinjitoz, është e domosdoshme ndihma juaj financiare për të sponsorizuar orkestrën dhe këngëtarin. Kjo nuk është vetëm një mbështetje për Shoqatën, por është një kontribut i drejtpërdrejtë për ruajtjen e traditës, forcimin e lidhjeve mes brezave dhe për të treguar dashurinë ndaj vendlindjes sonë të dashur – Kallarati.

GJYSMËVITI I PARË I VITIT 2025 ishte i mbushur me punë, dashuri dhe përkushtim për vendlindjen.

GJYSMËVITI I DYTË na pret me emocione edhe më të mëdha: Takimi i Brezave dhe botimi i Historikut të Kallaratis! Kallarati na bashkon, na frymëzon dhe na bën krenarë.

Falënderojmë të gjithë ata kallaratas dhe jo vetëm që që organizuan e ndihmuan financiarisht për realizimin e aktiviteteve për 6 – mujin e parë të vitit 2025, veçanërisht në nismën: "Mbill edhe ti një pemë në vendlindje", si dhe në Piknikun Pranveror në 'Fshatin e Djegur'.

IN MEMORIAM

ENTE LA MEÇAJ - DEDIKIM PËR HALLËN TIME, YLVIE HASAN VELÇA (MEÇAJ) ME RASTIN 6 - MUJORIT TË NDARJES NGA JETA

Gjysmë viti pa ty, hallë e dashur...

Gjysmë viti pa zërin tënd, pa fjalët e ngrohta, pa buzëqeshjen që mbulohej shpesh nga dhimbjet që të rëndonin shpirtin.

Ti ishe simbol i durimit dhe i përkushtimit, një grua e fortë që përballove me dinjitet plagët më të mëdha që mund t'i japë jeta. E pavarësisht gjithçkaje, zemra jote mbeti e bardhë dhe e ndritshme deri në fund të jetës.

Të kujtoj me mall e me mirënjohje për çdo kujtim të bukur që më ke lënë.

Prehu në paqe, hallë Ylvie.

Kujtimi yt jeton në zemrën time.

Me dashuri dhe mall,

Entela



IN MEMORIAM

SHOQATA “KALLARATI” KUJTON ME NDERIM GAFUR HASAN SHAMETAJ, NË 11-VJETORIN e NDARJES NGA JETA

Më 23 maj 2025 u mbushën 11 vjet nga ndarja nga jeta e Gafur Hasan Shametajt – një prej themeluesve të Shoqatës “Kallarati”, kryetari i saj i parë dhe kryeredaktori i gazetës me të njëjtin emër.

Gafuri ishte një intelektual i spikatur, skenarist i njohur i artit dhe humorit vlonjat, deputet i Vlorës në vitet e para të demokracisë, një zë i urtë dhe i guximshëm që dha kontribut të vyer për qytetin, krahinën dhe vendin e tij.

Me përkushtim dhe vizion, ai udhëhoqi shoqatën në vitet e para të saj, duke punuar pa u lodhur



për të ruajtur e përcjellë vlerat patriotike, kulturore dhe shoqërore të Kallaratis. Me fjalën dhe penën e tij, me organizimin dhe dashurinë për vendlindjen, ai la një trashëgimi që mbetet frymëzim për brezat.

Në këtë përvjetor të njëmbëdhjetë të ndarjes nga jeta, e kujtojmë me respekt të thellë bashkë me familjen, miqtë, kolegët dhe gjithë ata që e njohën dhe e çmuan atë.

Humbja e tij ishte e madhe, por kujtimi i tij do të mbetet përherë i gjallë në zemrat tona, në historinë e Kallaratis, të Vlorës, të Labërisë e më gjerë.

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të singerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. **Qofshin të paharruar!**

IN MEMORIAM

RUBRIKA: NJOFTIM PËR NDARJE NGA JETA NDAHET NGA JETA SHENA BEQIR GOLLOSHI (LAZE)

Me dhimbje të thellë njoftojmë ndarjen nga jeta të të ndjerës Shena Golloshi, bashkëshortja e të paharruarit Enver Golloshi – mësuesit të dashur nga Kallarati, dhe nëna e Drinit dhe Altisfer Golloshit. Shena Beqir Laze lindi në Tragjas në vitin 1939, në një familje me tradita patriotike dhe atdhetare. U martua me Enver Golloshin dhe së bashku ndërtuan një familje shembullore, duke rritur dhe edukuar me përkushtim dy fëmijët e tyre, Drinin dhe Altisferin.

Me punën e nderhme si rrobaqepëse dhe jetën e saj të përkushtuar, Shena mishëroi tiparet më të mira të gruas labe: dinjitetin, mikpritjen, përkushtimin ndaj familjes dhe dashurinë për vendlindjen.



Ishte një gjyshe e jashtëzakonshme për 7 nipërit dhe mbesat, të cilët i rriti me dashuri, përkujdesje dhe ndjenja të larta njerëzore.

Shtëpia e tyre në Lubonjë dhe në Vlorë ishte gjithmonë e hapur për çdo kallaratas dhe miq të tyre.

Shena dhe Enveri mbetën gjithmonë të lidhur fort me Kallaratin dhe Tragjasin, duke dhënë kontribut të vyer në komunitet dhe në Shoqatën “Kallarati”.

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Golloshi dhe Laze, të afërmeve dhe miqve të shumtë.

Qoftë i paharruar kujtimi i saj!

U prehtë në paqe!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA, BEJKUSH LESKAJ (LAÇAJ)

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” dhe familja Leskaj njoftojnë me dhimbje se është ndarë nga jeta, në moshën 89-vjeçare, Bejkush Leskaj (Laçaj) – bashkëshorti i Farisë, babai i Dallëndyshes, Aleksandrës, Andonit, Shkëlqimit, Gjergjit dhe Dukagjinit, si dhe vëllai i Luftër Leskaj (Laçaj).

Bejkushi lindi më 5 prill 1936 në Kallarati, në një familje atdhetare, nga prindërit Bino dhe Gastere Leskaj. U rrit si gjithë fëmijët e brezit të tij, mes mundimesh dhe vështirësish të mëdha, por me dashuri për punën dhe ndjenjën e fortë të përkushtimit ndaj familjes dhe vendlindjes.

Ai u martua me Farinë, bijë nga fisi Ribaj i Kallaratis, me të cilën rriti dhe edukoi me përkushtim gjashtë fëmijë të mrekullueshëm: Dallëndyshen, Aleksandrën, Andonin, Shkëlqimin, Gjergjin dhe Dukagjinin.

Bejkushi i përket brezit të blegtorëve të përkushtuar të Kallaratis, të cilët dhanë një kontribut të çmuar për zhvillimin e sektorit të blegtorisë dhe mirëqenien e fshatit. Ai punoi gjatë gjithë jetës me ndershmëri dhe



sakrificë në sektorin e blegtorisë – sa në një stan në tjetrin – atje ku kishte më shumë nevojë, duke qenë jo vetëm bari i dalluar, por edhe drejtues i këtij sektori. Çobanët e

asaj kohe me të drejtë konsiderohen ndër njerëzit që kanë mbajtur peshën më të rëndë të jetës kooperativiste, dhe Bejkushi ka qenë gjithmonë ndër më të vlerësuarit për

përkushtimin e tij në ato vite.

Vitet e fundit i kaloi në Vlorë, nën përkujdesjen e fëmijëve dhe sidomos të bashkëshortes Farisë, pa u shkëputur asnjëherë nga vendlindja e tij e dashur, Kallarati, nga njerëzit, miqtë dhe bashkëfshatarët.

Ai ishte një burrë zakoni, i trapezit, këngës dhe muhabetit, mik i mirë dhe njeri i dashur për të gjithë ata që e njohën.

Mosha dhe sëmundja e ndanë fizikisht nga familja dhe bashkëfshatarët, por Bejkush Leskaj (Laçaj) do të kujtohet gjithmonë si një bashkëshort i përkushtuar, prind shembullor, gjysh i dashur dhe një blegtor e drejtues i zoti, që dha gjithçka për familjen dhe Kallaratin.

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” i shpreh bashkëshortes, fëmijëve, vëllait dhe gjithë fisit Leskaj (Laçaj) ngushëllimet më të sinqerta dhe më të thella për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!

U prehtë në paqe!

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

Ec ngado **KALLARATIN** *mos e harro!*



Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Redaksia e Gazetës:

Anëtarë:

Prof. dr. Rami

MEMUSHAJ,

Hiqmet MEÇAJ,

Çize XHAFERAJ,

Eleni MEMUSHAJ,

Besnik GJONBRATAJ,

Riza MEMUSHAJ,

Selo QEJVANI.

Redaktor/korrektor:
Prof. Dr. Rami Memushaj

Graphic Designer:
A. Hysaj